



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 35

Prishtinë, më 29.3.2016, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popoviq, Emilija Redzepi.

Munguan : Haxhi Shala, Salih Salihu, Shaip Muja.

Të ftuar dhe pjesmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Duda Balje**, kryetare e komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 25.3.2016,
3. Shqyrtimi i rekomandimit për mbledhjen plenare për kandidatët e intervistuar,
4. Te ndryshme ;

Kryesuesja **Duda Balje** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 25.3.2016

Procesverbali nga data 25.3.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i rekomandimit për mbledhjen plenare për kandidatët e intervistuar

Kryesuesja hapi diskutimin rreth kësaj pike dhe konstatoi se zyra ligjore e kuvendit ka konfirmuar që mosha e kandidatit nuk paraqet pengesë ligjore për kandisim, si dhe pozita e këshilltarit politik gjithashtu nuk është pengesë ligjore ngase poçes fiton ai kandidat duhet të pasojë dorëheqja nga pozita politike. Sa i përket kandidates Kimete Pavataj që u votua nga komisioni për zëvendës drejtor, kryesuesja konstatoi me keqardhje se nuk plotëson kushtin ligjor ngase nuk ka vërtetim që dëshmon se ajo ka përvojë menaxheriale edhe pse nga komisioni ka pasur respektin ndaj gjinisë femrore, ndaj hapi diskutimin. **Srdjan Popoviq** potencoi rregullsinë e përzgjedhjes së kandidatëve nga komisioni sipas rregullave ligjore, ndërsa **Emilija Redzepe** gjithashtu me keqardhje u pajtua se kandidatja mos të shkoi por megjithatë votoi kundër këtij ndrimi me një kandidat tjetër për shkak të principit. **Murat Hoxha** potencoi se kandidati i radhës Halil Bllaca i plotëson kushtet dhe procedurat edhe sipas Ligjit për emërim të larta dhe nuk vlen kontestimi sipas ligjit për shërbimin civil, dmth pasi e emëron Kuvendi ai vazhdon këtë detyrë edhe nëse i mbush pas dy vitesh 65 vjet. **Adem Salihaj** u pajtua me faktin se komisioni ka respektuar gjininë femërore por në fakt duhet të respektohen fillimisht rregullat ligjore që do të thotë se kandidati i radhës Halil Bllaca duhet të renditet për këtë pozitë bashkë me kandidatin Staletoviq për pozitën e Zëvendës Drejtorit.

Komisioni votoi kandidatët për Zëvendës Drejtor, 4 vota për dhe një abstenim në favor të kandidatëve Bogoljub Staletoviq dhe Halil Bllaca, ndërsa për pozitën Drejtor është votuar në mbledhjen e kaluar Nazmi Jashari dhe Raif Preteni.

4...Të ndryshme

Në pikën vijues Kryesuesja propozoi shqyrtimin e pikave të mbetura nga mbledhja e kaluar, dhe u vendos si vijon :

- Rreth anëtarëve të propozuar nga Qeveria për Bordin Këshillëdhënës për mjedis **Adem Salihaj** ishte për solucionin e dëgjimit të tyre në një mbledhje konsultative të komisionit, ndërsa **Emilija Redzepe** në parim kundërshtoi përbërjen për shkak të mungesës të një anëtari nga minoritetet, por megjithatë u pajtua paraprakisht të ftohen të njëjtit në takim me komisionin kur do të kanë mundësi anëtarët e komisionit të njoftohen me detaje tjera rreth këtij Bordi, ndërkaq **Kryesuesja** sugjeroi takimin të mbahet të mërkurën në orën 11,00 kur do të ftohen këta zyrtar të propozuar nga Qeveria.

- **Murat Hoxha** hapi diskutimin rreth nismës së hartimit të ndryshimeve në ligjin për shpronësime sipas iniciativës nga Avokati i popullit ku sipas tij deri tani në Grupin punues çdo gjë ka shkuar si duhet, mirëpo në ndërkohë pas shqyrtimit të propozimeve tjera përveç atyre fillestare, është konstatuar se Kuvendi përkatësisht ky komision nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të hartuar një Ligj të tillë me gjithë ato ndryshime që sugjerohen. Ai sugjeroi komisionit për një kohë të shkurtër të dorëzohet raporti nga GP me shkrim, në mënyrë që të veprohet më tutje sipas rregullores dhe të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit që kjo nismë të kalojë në Qeveri përkatësisht ministrinë përkatëse, për shkak të kapaciteteve të mangëta profesionale të Kuvendit lidhur me hartimin e këtij Ligji, gjë që edhe komisioni u pajtua të hartohet ky raport dhe të procedohet më tutje.
- **Rreth Projektligjit për Obiliqin Kryesuesja** gjithashtu potencoi se Komisioni duhet përfundimisht të angazhohet rreth përfundimit të tij ngase leximi i parë është bërë më 8 tetor 2015. Gjatë diskutimeve u konstatua se Grupi punues duhet prapë të shpërndahet në Komision dhe të hartohen rekomandimet për Leximin e dytë, por paraprakisht Kryetarja të kontaktoi me z. Muja-kryesues i GP, dhe të renditen obligimet si duhet të veprohet më tutje për të përgatitur një draft të aktiviteteve të deritanishme, duke përmbledh aktivitetet që janë bërë në fund të legjislacionit të kaluar dhe në këtë legjislacion, rreth këtij projektligji.

Mbledhja përfundoi në orën 13,40.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Duda Balje